

## SKEDA INFORMUESE

### Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen “Binjakëzimi i Qyteteve” (Town Twinning) nën Programin CERV

#### Synimi i thirrjes:

Thirrja mbështet projekte që nxisin ndërveprimin ndërmjet qytetarëve të vendeve të ndryshme përmes binjakëzimit të qyteteve, duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjelltë, dialogun ndërkulturor dhe pjesëmarrjen qytetare në çështje që lidhen me të ardhmen e Bashkimit Evropian dhe vlerat e tij.

#### Fushat e veprimit të thirrjes

Projektet mund të trajtojnë tema si:

- Solidariteti brenda dhe jashtë kufijve të BE-së
- Debatet mbi të ardhmen e Evropës dhe përfitimet e integrimit evropian
- Pjesëmarrja demokratike dhe të drejtat e qytetarëve
- Parandalimi i dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve
- Aktivitetet kulturore dhe edukative për të forcuar identitetin evropian
- Aktivitetet që përfshijnë të rinjtë dhe fëmijët në mënyrë të barabartë

#### Rezultatet e pritshme

- Nxitja e miqësisë dhe mirëkuptimit ndërqytetar
- Rritje e ndjenjës së përkatësisë në BE
- Forcimi i lidhjeve afatgjata ndërmjet bashkive pjesëmarrëse
- Pjesëmarrje më e madhe e qytetarëve, përfshirë fëmijët, në jetën demokratike
- Përfshirja aktive e grupeve të marginalizuara dhe në disavantazh

#### Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet

**Aplikues të pranueshëm:** Aplikuesi kryesor dhe partneri/partnerët e tij duhet të jenë organ publik ose organizatë jofitimprurëse me personalitet juridik të themeluar zyrtarisht në një nga vendet e pranueshme.

Aplikuesit duhet të jenë **bashki** dhe/ose nivele të tjera të autoriteteve lokale ose komitete të binjakëzimit ose **organizata jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet lokale**.

**Konsorciumi:** të paktën **2 bashki** nga **2 shtete** të pranueshme (së paku njëri shtet duhet të jetë vend anëtar i BE-së).

**Numri i pjesëmarrësve në evente:** të paktën 50 pjesëmarrës, ku së paku 25 duhet të jenë pjesëmarrës ndërkombëtarë të ftuar nga partnerët.

#### Aktivitetet e pranueshme:

- workshop-e,
- seminare,
- konferenca,

- aktivitete trajnimi,
- takime me ekspertë,
- webinarë,
- aktivitete ndërgjegjësimi,
- evente kulturore, festivale, ekspozita,
- mbledhjen dhe konsultimin e të dhënash (të ndara sipas moshës dhe gjinisë),
- zhvillimin, shkëmbimet dhe përhapjen e praktikave të mira midis autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile,
- zhvillimin e mjeteve të komunikimit dhe përdorimin e rrjeteve sociale.

Perspektiva e barazisë gjinore duhet të merret parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të aktiviteteve të projektit, për të siguruar që ato të jenë të arritshme për gratë dhe burrat në kushte të barabarta, që si gratë ashtu edhe burrat të jenë në gjendje të marrin pjesë në aktivitete.

#### **Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:**

**Buxheti total i thirrjes: 5 milion euro**

**Financimi për çdo projekt: nga 8.455 euro deri në 50.745 euro**

Financimi do të jepet në formë **lump sum**, sipas numrit të pjesëmarrësve nga shtetet e projektit.

#### **Si bëhet aplikimi:**

Aplikimi bëhet online përmes sistemit të Komisionit Evropian Funding & Tenders Portal dhe duhet të përfshijë:

- Pjesën administrative (Pjesa A);
- Përshkrimin teknik të projektit (Pjesa B);
- KPI me të dhëna shtesë të projektit dhe kontributin e projektit në treguesit kryesorë të performancës së programit të BE-së për t'u plotësuar direkt në sistem;
- **Shtojca të detyrueshme dhe dokumente mbështetëse** (shabllone të disponueshëm për t'u shkarkuar nga Sistemi i Parashtrimit të Portalit, të plotësuar, mbledhur dhe ri- ngarkuar ):
  - Llogaritësi i shumës së përgjithshme;
  - Lista e projekteve të mëparshme (projektet kryesore për 4 vitet e fundit) (model i disponueshëm në Pjesën B). Nuk zbatohet për entitetet e sapokrijuara;
  - Një letër mbështetëse e nënshkruar nga një bashki (e aplikueshme për organizata jo fitimprurëse private që përfaqëson një autoritet vendor). Dokumenti duhet të sigurohet më së voni gjatë fazës GAP;
  - Për të gjithë pjesëmarrësit që zbatojnë aktivitete që përfshijnë fëmijë për organet private duhet të dërgohet një kopje e politikës së tyre, ndërsa për organet publike bëhet një deklaratë e politikës së mbrojtjes së fëmijëve.

#### **Kur është afati i fundit:**

**Afati i fundit për aplikim: 17 shtator 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

#### **Linku i thirrjes:**

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2025-CITIZENS-TOWN-TT>

